

Dr. Ramiz Abdyl

**MËDITJET PUNËTORE NË KOSOVË NË RAPORT  
ME SHPENZIMET E JETËS NËDËRMJET DY LUFTËRAVE  
BOTËRORE (1918—1941)**

*„(...) paga nuk është pjesë e punëtorit në mallin e prodhuar prej tij. Paga është një pjesë e mallrave që ekzistojnë që më parë, me të cilën kapitalisti blen një sasi të caktuar fuqie punëtore prodhuese”.*

M a r k s i

Nëpërmjet pagës nominale, përkatësisht shumës së parave për të cilën punëtori shitet te kapitalisti dhe pagës reale, që do të rthotë sasisë së mallrave që ai mund të blejë me ato para, pasqyrohet njëri ndër elementet kryesore të gjendjes ekonomike të klasës punëtore. Paga dhe shpenzimet e jetës kushtëzohen nga çmimet e artikujve të konsumit të gjerë, aftësisë blerëse të punëtorëve, papunësisë etj. Gjatë përcaktimit të vlerës së fuqisë punëtore në vendet e ndryshme, ose gjatë sqarimit të të ashtuquajturave dallime „nacionale” në lartësinë e vlerës së fuqisë punëtore, merren parasysh edhe shpenzimet për arsimimin e punëtorëve, roli i punës së fëmijëve dhe i grave, produktiviteti i punës dhe madhësia e tij intensive dhe ekstensive.<sup>1</sup>

Në kushtet e marrëdhënieve kapitaliste në prodhim, këta faktorë janë pjesë e pandashme e gjendjes ekonomike të çdo vendi dhe të çdo periudhe kohore. Se në ç’masë shprehet ashpërsia e tyre në vendet përkatëse, varet edhe nga niveli i luftës së organizuar të klasës punëtore për të përmirësuar gjendjen në të cilën ndodhet ajo.

Pesha e faktorëve të sipërpërmendur ra mbi supet e klasës punëtore në Jugosllavinë e atëhershme,<sup>2</sup> ku më shumë e ku më pak, varësisht nga niveli i zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe pjekuria klasore e punëtorëve të viseve të saj. Jugosllavia ishte ndër ato

---

<sup>1</sup> K. Marks, *Kapital*, Beograd, 1933, knj. I, 570, cituar sipas Dr. Ivan Kovačević, *Ekonomski položaj radničke klase u Hrvatskoj i Slavoniji 1867—1914*, Beograd, 1972, 102.

<sup>2</sup> Sveta Popović, *Položaj radnog čoveka u kapitalističkoj i socijalističkoj Jugoslaviji*, Beograd, 1965, 21.

vende, ku kriza ekonomike ndihej me ashpërsinë e saj të plotë dhe me një sërë çështjesh të pazgjidhura, me korrupsion, me plaçkë dhe spekulime të ndryshme.<sup>3</sup> Në Kosovë, kjo gjendje ishte më e theksuar, të cilën, pos rethanave që ishin karakteristike për viset e tjera të Jugosllavisë, e kushtëzuan edhe një varg specifikash, që e bënë gjendjen e klasës punëtore të kësaj treve më të rëndë se të shumicës së punëtorëve të Jugosllavisë.<sup>4</sup>

\* \* \*

Për gjendjen e pagave të punëtorëve në Kosovë gjatë kësaj periudhe hasen më tepër burime. Pos burimeve arkivale, shënime për pagat japin inspeksionet e punës, odat e punëtorëve, shoqatat profesionale të punëtorëve, shtypi etj. Shënime lidhur me formimin e pagave mesatare jipnin Enti Qendror për Sigurimin e Punëtorëve (SUZOR) dhe entet krahinore për sigurimin e punë-

<sup>3</sup> Metodija Sokolovski, *Najamtnina u staroj Jugoslaviji*, Beograd, 1951, 13.

<sup>4</sup> Specifikat që e bënin të dallohej Kosova nga shumë vise të tjera të Jugosllavisë, e që u reflektuan në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjendjen ekonomike të klasës punëtore sipas mendimit tonë janë:

— mungesa e lirive elementare të shumicës së punëtorëve të Kosovës dhe ushtrimi i presionit në vazhdueshëm mbi ta deri në shfarosje fizike (Dr. Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941—1945*, Prishtinë, 1971, 28, Hajredin Hoxha, *Proces nacionalne afirmacije Albanske nacionalnosti u Jugoslaviji*, tezë doktoranture e mbrojtur në Fakultetin Filozofik të Lubjanës më 1973, Hajredin Hoxha, *Elementet e presionit ekonomik ndaj shqiptarëve*, Përparimi nr. 4, 1970, 312, „Socijalistička Zora”, nr. 38, 12 qershor 1920),

— Shtypi përparimtar i kohës Kosovën dhe Maqedoninë i quante koloni jugosllave — shih „Socijalistička Zora”, nr. 3, 7 nëntor 1920.

— derisa në viset e tjera të Jugosllavisë bëheshin përpjekje për rimëkëmbjen e vendit nga pasojat e Luftës Botërore, në Kosovë edhe për një kohë vazhdoi gjendje lufte (Hajredin Hoxha, *Proces...* 81, Dr. Limon Rushtiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë 1918—1928*, Prishtinë, 1981, 47—52, „Radničke Novine”, nr. 84, 7 prill 1920, „Socijalistička Zora”, nr. 86, 25 shtator 1920),

— zbatimi i reformës së padrejtë agrare dhe kolonizimit në Kosovën mjaft të popullzuar, që u shpreh negativisht në standardin e përgjithshëm të popullsisë, pra edhe në gjendjen ekonomike të klasës punëtore (shih Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1918—1941*, Priština, 1981, 231, Kosta Novaković, *Kolonizimi dhe serbizimi i Kosovës*, „Liria Kombëtare”, Gjenevë 15 shtator 1931). Vetëm gjatë viteve 1921—1931 nga pasojat e reformës agrare dhe kolonizimit nga fshatrat e Kosovës migruan në qytete 14.000 familje varfanjakësh, të cilët e shtuan dukshëm numrin e punëtorëve të papunë, dhe në këtë mënyrë u bënë konkurrencë serioze e punëtorëve të punësuar dhe ndikuan në zbritjen e pagave të tyre (Rastko S. Purić, *Južni Pregled* nr. 5, 1939, Shkup, 60).

Këta faktorë dhe të tjerë, ndikuan që Kosova të ngecte prapa shumë viseve të tjera të Jugosllavisë. Kjo gjendje u shpreh te popullsia autoktone e kësaj treve. Kështu, p.sh. të ardhurat nacionale të popullsisë shqiptare në qytetet e Kosovës në vitin 1935 ende nuk e kishin arritur nivelin e viteve 1909—1912. Po kjo gjendje është edhe te elementi autokton serb. Ndërkaq, te pjesa më e madhe e elementit kolonist të ardhurat nacionale ishin më të larta. Në anën tjetër, derisa gjatë viteve 1929—1938 industria në Serbi qe rritur për 44%, në Slloveni 10%, në Mal të Zi 11%, në Kosovë dhe në Maqe-

torëve (OUZOR). Mirëpo, të dhënat e këtyre enteve, edhe pse janë të sistematizuara dhe të përpunuara mirë, kanë mjaft dobësi, si p.sh. diferenca e madhe ndërmjet grupeve të pagave të punëtorëve të siguruar,<sup>5</sup> mospërfshirja e disa profesioneve të punëtorëve në këto grupe pagash,<sup>6</sup> si dhe rangimi i pagave të çirakëve në grupin e parë të punëtorëve të siguruar, të cilët në realitet nuk shpërbleheshin.<sup>7</sup> Për këtë punim ne kemi shfrytëzuar edhe shënimet e mbledhura në terren. Të gjitha këto burime jemi përpjekur t'i shfrytëzojmë në mënyrë kritike.

doni vetëm 8% (Dr. Haki B. Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918—1941*, Prishtinë, 1981, 14, 19). Duhet shtuar se në gjendjen ekonomike të klasës punëtore në Kosovë ka ndikuar edhe niveli i vetëdijes së saj klasore, përkatësisht aftësia e organizimit të luftës për të përmirësuar gjendjen, por rrethanat e lartpërmendura kanë luajtur rolin e tyre në gjendjen ekonomike të saj.

<sup>5</sup> Entet e përmendura gjithë punëtorët e siguruar i ndanin në 17 grupe sigurimi. Prej vitit 1926 u shtua edhe një grup i këtyre, ndërkaq nga janari i vitit 1928 u hoqën gjashtë grupet e para dhe ngelën gjithsej 12 grupe (shih „Službene Novine“ *Kraljevine Srba, Hrvata i Slovenaca*, nr. 117, 30 maj 1920, Rastko S. Purić, *Ustanove za socijalno staranje u Južnoj Srbiji*, Shkup, 1932, 14). Çdo grup i këtyre i sigurimit i përgjigjej lartësisë së caktuar të fitimit të pagave të punëtorëve prej 2.40 din. (grupi i parë i siguruar), deri më 40.00 din. (grupi i fundit i siguruar), përkatësisht prej vitit 1932 prej 2—8 din. dhe prej 48—56 din. (shih Rastko S. Purić, *Rabotnički Jug*, Shkup, 1937, 47, 48). Gjatë kësaj ndarjeje, po që se fitimi nuk ishte i caktuar, me ditë, por me ndonjë periudhë tjetër kohore, atëherë lartësia e fitimit ditor merrej dita e gjashtë e javës, pjesa e 25 e fitimit mujor, ose pjesa e 300 e fitimit vjetor. Po që se fitimi nuk ishte i caktuar me kohë (pagë akor, de ose me copë etj.), ajo caktohej nga shumica që biente në ditë, në javë ose në muaj. Punëtorët të cilët për punën e tyre nuk merrnin kurrfarë shpërblimi radhiteshin në grupin e parë (shih Dr. Petar Milosavljević, *Položaj radničke klase Srbije 1918—1929*, Beograd, 1972, 50). Siç shihet dallimi i madh ndërmjet grupit të parë të pagave dhe atij të fundit ishte shumë i madh, gjë që ishte në dëm të grupeve të ulëta të sigurimit, përkatësisht të grupeve me paga të vogla, në të cilat bënin pjesë shumica e punëtorëve të Kosovës. Në anën tjetër në grupin e parë, me pagat shumë të mëdha bënin pjesë edhe administratorët të ndryshëm komunalë etj., të cilët nuk mund të merren për punëtorë.

<sup>6</sup> Në formimin e kësaj mesatareje nuk merrnin pjesë punëtorët hekurudhorë dhe xehetarët, të cilët kishin entet e tyre të veçanta të sigurimit. Në formimin e mesatares së pagave nuk merrnin pjesë as argatët dhe kurbetçinjtë, të cilët do të ndikonin në uljen e mesatares, pasi kishin paga shumë të vogla (Rastko S. Purić, *Rabotnički Jug*, 126—127). Gjatë formimit të mesatares nuk merrej parasysh mosha dhe gjinia, gjë që edhe këto kategori punëtorësh do të ndikonin në uljen e mesatares me pagat e tyre tejet të ulëta, e sidomos ato të grave (Dr. P. Milosavljević, *Položaj Radničke klase Srbije 1918—1929*, 50).

<sup>7</sup> Ramiz Abdylji, *Gjendja dhe pozita e çirakëve në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore 1918—1941*, Rilindja 8—25 tetor 1983. Në Kosovë gjatë kësaj periudhe paguhej një pjesë shumë e vogël çirakësh, kryesisht ata të xeheroreve, të cilët ishin përqindje shumë e vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të tyre. (shih për këtë Rastko Purić, *Južni pregled*. 29—32, *Položaj radnika i sindikalni pokret u Jugoslaviji 1929—30. god.* Izveštaj uprave Ujedinjenog radničkog sindikalnog saveza Jugoslavije II redovnom Kongresu 27—28 septembra u Zagrebu, Beograd, 1931, 38). Duhet shtuar se në Kosovë gjatë kësaj kohe nuk siguroheshin të gjithë punëtorët. Siguroheshin kryesisht punëtorët me paga të mëdha, të cilët ndikonin në ngritjen e mesatares së pagave të përgjithshme të punëtorëve (shih Rastko S. Purić, *Radništvo i sirotinja Južne Srbije*, Socijalni Arhiv nr. 8—9, Beograd, 1936, 254—255).

Menjëherë pas proklamimit të Mbretërisë SKS, borgjezia, për t'i evituar pasojat e Luftës dhe çrregullimet e tjera ekonomike e shoqërore dhe për të nxjerrë profitet e „ligjshme” të saj, pos masave të tjera ekonomike, filloi ngritjen e çmimeve të artikujve të konsumit të gjerë,<sup>8</sup> të cilat u ngritën në mënyrë të pakontrolluar gjatë gjithë periudhës së vështruar.<sup>9</sup> Kësisoj rritej vazhdimisht diferenca ndërmjet pagave nominale dhe reale të punëtorëve, të cilat as për së afërmi nuk i përmbushin kërkesat e jetesës së tyre.<sup>10</sup> Në Kosovë gjendjen e luftës, përkatësisht të trazirave e shfrytëzuan elementet e ndryshme, kontrabandistë, tregtarë etj, për të bërë spekulime të mëdha me çmimet e artikujve të konsumit të gjerë.<sup>11</sup> Kjo gjendje shkaktoi shpërpjestim të madh ndërmjet pagave nominale dhe reale të punëtorëve të kësaj treve. Madje disa punëtorëve nuk u paguheshin pagat me muaj të tërë,<sup>12</sup> ose ata detyroheshin nga organet qeveritare të punonin pa kurrfarë shpërblimi,<sup>13</sup> të cilët në fakt ishin të gjykuar, të jetonin dhe të punonin të uritur.

Ashpërsia ndërmjet punës dhe kapitalit mori përmasa edhe më të mëdha pas shpalljes së Obznanes dhe Ligjit mbi mbrojtjen e shtetit. Ky akt, pos të tjerash, i jipte grusht të rëndë lëvizjes punëtore dhe njëkohësisht punëdhënësve u mundësonte t'i zbrisnin pagat e punëtorëve sipas dëshirës së tyre.<sup>14</sup>

Gjendja e punëtorëve në Kosovë, sikurse edhe e atyre në Maqedoni dhe Sanxhak, ishte më e keqe se e punëtorëve të Serbisë, gjë që pasqyrohej edhe në diferencë pagash.<sup>15</sup> Punëtorët e këtyre viseve, jo vetëm që kishin paga më të ulëta se punëtorët në Serbi, por nga organet shtetërore trajtoheshin si të rrezikshëm. Po qe se

<sup>8</sup> Shtrenjtimitet në vitin 1920 në krahasim me vitin 1914 ishin: buka 900%, mielli 600%, mishi i kafshëve 800%, i deles 1120%, djathi 1100%, grosha 700%, qumështi 600%, orizi 1700%, patatja 1900%, gjalpi dhe lakra 900%. Pra, derisa gjatë kësaj periudhe çmimet e artikujve të konsumit të gjerë u ngritën rreth 1200%, pagat vetëm 700% („Radničke Novine”, nr. 125, 23 maj 1920).

<sup>9</sup> AJ-244/b, „Radničke dnevnice” i skupoća, Ujedinjeni Sindikati nr. 1—2 1938, Sveta Popović, *Položaj...*, 21.

<sup>10</sup> Metodija Sokolovski, *Najamnina u Staroj Jugoslaviji*, 13.

<sup>11</sup> „Socijalistička Zora”, nr. 97, 14 tetor 1920, nr. 114, 9 nëntor 1920, dhe nr. 116, 12 nëntor 1920, „Radničke Novine”, nr. 82, 7 prill 1920 dhe nr. 3, 3 janar 1920.

<sup>12</sup> „Radničke Novine” e 3 janarit të vitit 1920, lidhur me gjendjen e punëtorëve të Pejës shkruante: „... në Pejë punëtorët, sikundër edhe mbarë popullsia e varfër, jetojnë në mjerim të madh. Veçanërisht punëtorët janë në gjendje mizore. Ata janë lënë në mëshirën e zotërinjve, të cilët fuqinë punëtore e shfrytëzojnë deri në pakufi. Punëtorëve të Sektorit të Ndërtimitarisë nuk u jipen pagat me muaj të tërë. Këta punëtorë duhet të jenë të uritur, të persekutuar dhe të shkojnë të zbathur e të lekosur...”.

<sup>13</sup> Rabaxhinjët e Prizrenit detyroheshin nga organet komunale të bartin mall në relacionin Prizren — Ferizaj dhe Prizren — Gjakovë, ndësa gjatë dimrit bartin drunjt për ushtrinë, ta hidhnin berllokun jashtë qytetit etj. pa kurrfarë shpërblimi („Socijalistička Zora” nr. 18, 31 mars 1920).

<sup>14</sup> Metodija Sokolovski, *Najamnina u Staroj Jugoslaviji*, 16.

<sup>15</sup> *Godišnjak o radu Ministarstva socijalne politike u god. 1918—1921*, III deo, Izveštaj inspekcije rada za god. 1921. Beograd 1922, 230—232.

inspeksionet e punës merrnin guxim t'i mbronin nga gjendja e tyre e mjeruar, organet qeveritare kërkonin të ndalohej puna e mëtejme e tyre.<sup>16</sup> Një pjesë e punëtorëve të Kosovës gjatë kësaj kohe kishte paga aq të ulëta, sa mezi arrinin ta siguronin minimumin e ekzistencës.<sup>17</sup>

Gjatë viteve 1921—1926 pagat e punëtorëve në Kosovë tregojnë tendencë të vogël të ngritjes, por ato qëndronin gjithnjë në shpërpjestim të madh me çmimet e artikujve të konsumit të gjere. Gjatë kësaj periudhe vërehet dallimi i dukshëm ndërmjet pagave të punëtorëve të kualifikuar dhe atyre të pakualifikuar. Ky dallim ishte më i theksuar ndërmjet pagave të punëtorëve zejtarë, të cilat në vitin 1924 ishin:<sup>18</sup>

	pagat minimale	pagat maksimale
punëtorët e kualifikuar	20 din.	45 din.
punëtorët e pakualifikuar	10 din.	20 din.

Një vit më vonë dallimet ndërmjet pagave të punëtorëve të kualifikuar dhe të pakualifikuar rrobaqepës dhe këpucëtarë ishin:<sup>19</sup>

	pagat minimale	pagat maksimale	pagat mesatare
punëtorët këpucëtarë	25 din.	50 din.	30 din.
punëtorët rrobaqepës	25 din.	65 din.	45 din.

Pagat reale të punëtorëve zdrukthtarë gjatë kësaj periudhe gjithashtu tregonin rënie të vazhdueshme. Në gjendje pak më të mirë ishin punëtorët e pyjeve dhe të sharrave në Mitrovicë Mirëpo edhe ndërmjet kategorive të këtyre punëtorëve ekzistonin dallime në paga. Kështu, p.sh., punëtorët e sharrave „Ibar” dhe „Zveçan” në vitin 1926 kishin këto paga:<sup>20</sup>

	pagat maksimale	pagat minimale
punëtorët në sharra dhe në pyll	30 din.	40 din.
zdrukthëtarët	30 din.	40 din.
punëtorët që punonin në rregullimin e dërrasave	27 din.	29 din.

<sup>16</sup> *Po aty*, 6—7, sikurse para, ashtu edhe pas shpalljes së Obznanes, punëtorët e Kosovës, të Sanxhakut dhe të Maqedonisë jo vetëm që gjcndeshin në gjendje shumë të keqe ekonomike, por për çdo intervenim të inspeksionit të punës për mbrojtjen e të drejtave të tyre, inspeksioni përkatës shpallej për komunist dhe kërkohej t'i ndalohej puna e mëtejshme.

<sup>17</sup> „Socijalistička Zora”, nr. 97, 14 tetor 1920. Artikullshkruesi për gjendjen e punëtorëve që punonin në rrugën Prizren — Ferizaj ndër të tjera shkruante: „(...) Gjithandej në tokën shkëmbore të banuar me shqiptarë mbretëron gjendja mizore. Në rrugën ndërmjet Ferizajt dhe Prizrenit punojnë numër i madh shqiptarësh. Shumica e tyre janë gjysmë të zhveshur dhe shihen se ata mezi i kanë fshehur pjesët e „turpshme” të trupit të tyre me leckë thasësh. Ndërkaq, shpërblimi i tyre është më se mizor. Buka e misrit është ushqim i tyre i vetëm. Ata shtyhen si të lumtur që punojnë dhe familjeve të tyre u sigurojnë kafshatën e misrit. . .”.

<sup>18</sup> *Raportet e Inspeksionit të punës të Shkupit 1921—1926*.

<sup>19</sup> *Po aty*.

<sup>20</sup> „Radničke Novine”, nr. 12, 24 mars 1926.

Mesatarja e pagave të këtyre punëtorëve do të ishte edhe më e vogël, po të merret parasysh fakti se një përqindje e madhe e punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve ishin punëtorë sezonalë.<sup>21</sup> pagat e të cilëve do të ndikonin në zbritjen e pagave të përgjithshme. Madje, kësaj kategorie punëtorësh ndodhte që punëdhënësit me muaj të mos ua paguanin mëditjet.<sup>22</sup>

Si rezultat i paraqitjes së krizës në bujqësi, e cila u shpreh edhe në degët e tjera të ekonomisë, duke filluar prej vitit 1926, pagat nominale të punëtorëve shprehin tendencë të rënies së theksuar. Kështu, p.sh., në vitin 1929 pagat e punëtorëve zdrukhtarë silleshin prej 10—35 din.<sup>23</sup> Mirëpo, pagat e këtyre punëtorëve dalloheshin nga një qytet në tjetrin. Gjithsesi pagat më të ulëta kishin zdrukhtarët e Prizrenit, të cilat ishin dukshëm më të ulëta se ato të shokëve të tyre në Mitrovicë. Ndërkaq, pagat e këtyre të fundit ishin më të ulëta, se ato të punëtorëve po të këtij profesioni në Shkup. Gjendja e pagave të zdrukhtarëve në Prizren, në Shkup dhe në Mitrovicë në vitin 1929 ishte:<sup>24</sup>

	pagat minimale	pagat maksimale	pagat mesatare
zdrukthetarët e Prizrenit	5 din.	45 din.	25 din.
zdrukthetarët e Mitrovicës	15 din.	45 din.	50 din.
zdrukthetarët e Shkupit	35 din.	50 din.	42,5 din.

Sihet se në këtë vit pagat mesatare të punëtorëve zdrukthetarë të Prizrenit dhe të Mitrovicës ishin 14,5 dinarë më të ulëta se pagat mesatare po të këtij profesioni punëtorësh të Shkupit. Ndërkaq, në këtë vit pagat mesatare të këtyre punëtorëve në Kosovë ishin 30% më të ulëta se mesatarja e pagave jugosllave.<sup>25</sup>

Pagat e punëtorëve zejtarë në Kosovë gjatë viteve 1926—1928 ranë për 2—3 herë.<sup>26</sup> Vërehet edhe më tej dallim ndërmjet pagave të këtyre punëtorëve të një qyteti nga tjetri. Dallim më të madh kishin pagat e zejtarëve të Prizrenit dhe ato të Mitrovicës, të cilat në vitin 1928 ishin:<sup>27</sup>

<sup>21</sup> Në këtë kohë Sharra „Zvečan” kishte rreth 86 punëtorë të përherëshëm, ndërkaq në pyje punonin 200—300 punëtorë sezonalë. Po kaq punëtorë sezonalë kishte edhe ndërmarrja „Treska” e Shkupit, e cila i eksploatonte pyjet e Mitrovicës. (Shih *Izveštaj CRSOJ I Kongresu*, 22, „Organizovani Radnik”, nr. 2, 7 gusht 1927, Obnavljanje centrale Saveza drvodelskih radnika), të cilët punonin vetëm 5—6 muaj në vit, që do të thotë se pagat e tyre ishin shumë më të ulëta seç i paraqisnin inspeksionet e punës. Kjo kategori punëtorësh punonte në kushte tejet të vështira sidomos gjatë muajve të dimrit, kur bënte ftohtë i madh (Jozef Bek er, *Položaj industrijskih radnika u Jugoslaviji*, Zagreb, 1928, 82—87).

<sup>22</sup> Në vitin 1925 të pyjeve në Mitrovicë nuk iu pagua shuma akorde prej 40.000 din. (Izveš. inspek. rada za 1925, 141).

<sup>23</sup> *Položaj radničke klase u Srbiji*, Izveštaj radničkih komora 1926—1931, Beograd, 1932, 73—74.

<sup>24</sup> *Po aty*.

<sup>25</sup> *Metodija Sokolovski, Najamnina u staroj Jugoslaviji...*, 61.

<sup>26</sup> *Položaj radničke klase u Srbiji*, Izveštaj..., 23—31.

<sup>27</sup> *Po aty*, M. V aviq, *Štrajkovi i druge akcije radničke klase u Kosovskoj Mitrovici između dva rata*, Simpoziumi mbi Mitrovicën, Mitrovicë 1979, 169.

	pagat minimale	pagat maksimale
të punëtorëve të Prizrenit	20 din.	40 din.
të punëtorëve të Mitrovicës	20 din.	40 din.

Dallime të mëdha kishte ndërmjet pagave të punëtorëve të kualifikuar dhe atyre të pakualifikuar që punonin në ndërtimin e hekurudhës Mitrovicë — Rashkë. Në vitin 1928 pagat e punëtorëve të kualifikuar ishin 3 herë më të mëdha se ato të punëtorëve të pakualifikuar.<sup>28</sup>

Pagat nominale të punishteve të tjegullave dhe të tullave gjatë viteve 1926—1930 gjithashtu tregonin tendencë të rënies. Pagat e punëtorëve të këtij profesioni të firmës Lazar P. Zharkoviç në vitet 1926—1930 ishin konstante (12—17 din<sup>29</sup>), ndërkaq numri i punëtorëve të kualifikuar ishte shumë i vogël, gjë që ndikonte në rënien e mesatares së përgjithshme të pagave të këtyre punëtorëve.

Në gjendje të keqe ekonomike ishin në përgjithësi punëtorët e pakualifikuar, të cilët e përbënin përqindjen më të madhe të punëtorëve të kësaj treve. Prej tyre dalloheshin disa kategori, si rabaxhinjët, hamejtë, argatët etj., të cilët me pagat e tyre të ulëta ishin në gjendje veçanërisht të vështirë ekonomike.<sup>30</sup>

Kriza e madhe ekonomike e intensifikoi edhe më tepër rënien e pagave të punëtorëve të kësaj treve. Duke filluar prej vitit 1930 e deri në vitet 1935—1936 ato pësuan rënie të theksuar. Pas këtyre viteve, deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore, pagat nominale të punëtorëve të Kosovës tregojnë ngritje të vogël, por në krahasim me ngritjen e shfrenuar të çmimeve të artikujve të konsumit të gjerë ato në realitet pësojnë rënie të madhe.<sup>31</sup>

Pas fillimit të krizës ekonomike, rënie pësojnë pagat e gjitha profesioneve të punëtorëve të Kosovës, sidomos pagat e zejtarëve, të cilat në vitin 1934 silleshin prej 4—40 din. Në gjendje më të keqe ishin punëtorët zejtarë të Prizrenit me pagat e tyre shumë të vogla, të cilat gjatë këtij viti silleshin prej 6—7 din. Bukëpjekësit në Mitrovicë pagat prej 10—15 dinarë, ndërkaq rrobaqe-

<sup>28</sup> *Položaj radničke klase u Srbiji 1926—1931*, Beograd 1932, 237—238, ndërkaq sipas „Radničke Novine”, të datës 8 gusht 1928.

Pagat e punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje ishin:

Pagat min. të punët. të pakualif. 22, pagat maksimale 40.

Pagat min. të punët. të kualif. 40, pagat maksimale 57.

<sup>29</sup> AJ-65-343, „Radničke Novine”, 14 korrik 1933.

<sup>30</sup> Rastko S. Purić, *Rabotnički Jug.*, 45, 106.

<sup>31</sup> AJ-244/A, AJ-244/C — Opseg neuposlenosti.

pësit e këtij qyteti kishin paga prej 10—12 din. Po në këtë gjendje ishin pagat e zejtarëve në Gjakovë.<sup>32</sup>

Gjatë kësaj periudhe pagat e zdrukthëtarëve të Kosovës pësuan rënie të dukshme. Kështu, në vitin 1937 pagat e këtyre punëtorëve në Mitrovicë ishin 10 din.<sup>33</sup> Një vit më vonë pagat e punëtorëve të pyjeve në Rugovë ishin 16,66 din.<sup>34</sup> Në vitin 1939 pagat e zdrukthëtarëve të „Ozrenit” të Pejës ishin 17 din., ndërkaq pagat e emigrantëve rusë, po në këtë ndërmarrje, ishin shumë më të mëdha. Ata, si punëtorë të privilegjuar, i kishin mëditjet prej 30—35 din.<sup>35</sup> Pagat e punëtorëve zdrukthëtarë deri në vitin 1940, përkundër ngritjes së artikujve të konsumit të gjerë nuk pësuan kurrfarë ndryshimi.<sup>36</sup> Në fakt pagat e këtyre punëtorëve gjatë viteve 1932—1935 pësuan rënie 8,3%, ndërsa gjatë viteve 1935—1937 ato u rriten vetëm 13,2%. Gjatë viteve 1937—1938 pësuan rënie 34,6%, ndërkaq gjatë viteve 1938—1940 u ngriten 31,6%,<sup>37</sup> por në krahasim me ngritjen e çmimeve të artikujve të konsumit të gjerë ato pësuan rënie.

Në gjendje pak më të mirë në këtë drejtim ishin punëtorët ndërtimorë, që punonin në ndërtimin e hekurudhave të Kosovës. Në vitin 1934 pagat mesatare të punëtorëve që punonin në ndërtimin e hekurudhës Fushë Kosovë — Pejë ishin 10.15 dinarë,<sup>38</sup> ndërkaq pagat e punëtorëve të së njëjtës firme që punonin në ndërtimin e hekurudhës Kurshumli — Prishtinë në vitin 1937 ishin 35—100 din.<sup>39</sup> Pagat e punëtorëve të kësaj firme gjatë viteve 1937—1939 ishin.<sup>40</sup>

---

<sup>32</sup> „Radničke Novine”, nr. 2, 2 dhjetor 1934, dhe nr. 38, 21 shtator 1934. Po aty nr. 34. 24 gusht 1934.

<sup>33</sup> M. Vavić, *Štrajkovi...*, 169.

<sup>34</sup> „Radničke Novine”, nr. 38, 16 shtator 1938, 8.

<sup>35</sup> „Radničke Novine”, nr. 2, 12 dhjetor 1934. Pas ngadhënjimit të Revolucionit të Tetorit, një pjesë e reaksionit rusomadh gjeti strehim në Mbretërinë SKS. Pushteti i atëhershëm ata i vendosi sidomos në viset ku rezistenca kundër regjimit ishte më e fuqishme. Në Kosovë, pjesa më e madhe e tyre u vendos në qytetet e Rrafshit të Dukagjinit (Pejë, Gjakovë dhe Prizren), të cilët u përdorën për shuarjen e Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe çdo forme tjetër të rezistencës që ishte kundër rendit në fuqi. Nga ky element u rekrutuan mercenarë, të cilët morën pjesë aktive në shuarjen e Revolucionit të Qershorit në Shqipëri (më 1924). Prania e tyre në Kosovë ndikoi veçanërisht në keqësimin e gjendjes ekonomike të klasës punëtore, meqenëse ata, jo vetëm që u punësuan kur papunësia ishte në shkallë shumë të lartë, por në krahasim me punëtorët vendës ishin të privilegjuar në çdo pikëpamje. Punëdhënësit ata i venin në vendet me përgjegjësi dhe u jipnin të drejtë të sillshin ndaj punëtorëve vendës si kapadahunj.

<sup>36</sup> „Ujedinjeni Sindikati”, nr. 26, 30 qershor 1940.

<sup>37</sup> Shih raportet e inspeksionit të Shkupit 1931—1940.

<sup>38</sup> „Socijalni Arhiv”, nr. 1—2 1934, f. 119, „Radničke Novine”, nr. 13. 30 mars 1934, AK-XVIII, k-5145-1936, Raportet e inspeksionit të punës të Shkupit, për vitet 1939—1940.

<sup>39</sup> Nga shënimet e mbledhura në terren.

<sup>40</sup> Raportet e Inspeksionit të punës të Shkupit 1935—1940.

	pagat minimale	pagat maksimale
pagat e punëtorëve të kualifik.	25 din.	30 din.
pagat e punëtorëve të pakualif.	18 din.	22 din.

Duhet shtuar se pagat e punëtorëve të tjerë ndërtimorë ishin dukshëm më të ulëta. Gjatë viteve 1934—1937 ato silleshin prej 3—10 dinarë,<sup>41</sup> andaj gjendja ekonomike e këtyre punëtorëve ishte tejte e vështirë. Në gjendje shumë të vështirë ekonomike ishin edhe punëtorët e shtypshkronjave të Kosovës. Ata gjatë viteve 1934—1936 shpërbleheshin për punën e tyre të mundimshme vetëm me 6—7 dinarë.<sup>42</sup>

Rënie e pagave pati edhe te punëtorët e centraleve elektrike të Kosovës pas fillimit të krizës ekonomike. Diferenca e pagave të punëtorëve të kualifikuar dhe atyre të pakualifikuar të këtyre ndërmarrjeve ndërmjet viteve 1933—1935 shtohet vazhdimisht. Ndërkaq prej vitit 1935 deri në vitin 1938 ato u ngritën për 1,5 din.\*

Edhe pagat e punëtorëve të xehetarisë gjatë viteve 1931—1940 tregojnë tendencë të rënies së vazhdueshme. Vërehet dallim i dukshëm ndërmjet pagave të punëtorëve të së njejtës ndërmarrje. Kjo më së miri shihet te xehetarët e Trepçës. Në anën tjetër, dallim të theksuar kishte ndërmjet pagave të punëtorëve të Trepçës dhe të xeheroreve të tjera të Kosovës.<sup>43</sup>

Në gjendje tejte të vështirë ekonomike gjatë kësaj periudhe gjendeshin kategoritë e punëtorëve argatë, rabaxhinj, hamej, dhe kurbetçinj.<sup>44</sup>

Rënia e vazhdueshme e mëditjeve reale, e shkaktuar nga çrregullimet ndërkombëtare të këmbimit të të mirave natyrore, krizës ekonomike dhe ngritjes së shfrenuar të çmimeve të artikujve të konsumit të gjerë, si dhe ankesat e shumta të punëtorëve për gjendjen e tyre të mjerueshme ekonomike, që rezultat i sjelljes së „Dekretligjit mbi verifikimin e pagave minimale, nënshkrimin e kontratave kolektive, trajtimin dhe arbitrazhin” me 13 shkurt të vitit 1937.<sup>45</sup>

Mirëpo, nga Dekretligji nuk u plotësuan as për së afërmi kërkesat e punëtorëve për të rregulluar në mënyrë ligjore mëditjet e

<sup>41</sup> Rastko S. Purić, *Rabotnički Jug*, 48, 49.

<sup>42</sup> Branislav Nožica, *Sećanje na štrajk štamparskih šegrta štamparije „Novi Svet” u Kosovskoj Mitrovici 1935 god.* (punim në dorëshkim).

\* AJ-65-108, 965-1042 dhe 605, Nga shënimet e mbledhura në terren.

<sup>43</sup> Shih për këtë Arkivi Ekonomik i Trepçës, listat e pagave të punëtorëve të Trepçës, Janjevës dhe Novo Bërdos, Položaj rudarskih radnika, Beograd 1936, f. 20.

<sup>44</sup> Rastko S. Purić, *Naličja... 9—12*, Rastko S. Purić, *Rabotnički Ju*, .. 45—51, „Radničke Novine”, nr. 1934, u kraju gde se radi samo za proju.

<sup>45</sup> „Ujedinjeni sindikati”, nr. 1—2, 1935, Zakon o minimalnim nadnicama, „Ujedinjeni Sindikati”, nr. 3—4 1938 — Uredba o minimalnim nadnicama.

tyre minimale. Përkundrazi, Dekretligji u përdor si mjet i luftës së punëdhënësve kundër punëtorëve dhe organizimit të tyre.<sup>46</sup>

\* \* \*

Për të konkretizuar atë që u tha deri më tash lidhur me pagat e punëtorëve të Kosovës gjatë periudhës së vështruar, kemi bërë përpjekje që këtë gjendje ta paraqesim nëpërmjet tabelave të shprehura në grafikun.<sup>47</sup> Sa për ilustrim e kemi prezentuar gjendjen e pagave gjatë viteve 1930—1940. Duhet shtuar se nuk mund të flitet për ndonjë mesatare absolute të pagave të punëtorëve të kësaj treve, por kjo gjendje do të ishte pasqyrë e përafërt e gjendjes së pagave mesatare të punëtorëve të Kosovës në këtë periudhë.

### a. Pagat e punëtorëve zejtarë

Nga tebele nr. 1 është bërë grafikoni nr. 1, ku janë paraqitur lëvizjet e pagave të punëtorëve zejtarë gjatë viteve 1930—1940 (pagat minimale, mesatare dhe ato maksimale).


Viti	Mëditja minimale	Mëditja maksimale	Mëditja mesatare
1930	10.30	30.40	20.35
1931	9.00	27.90	18.45
1932	8.70	25.00	16.85
1933	7.40	23.00	15.20
1934	6.90	22.00	14.45
1935	6.20	20.00	13.10
1936	7.00	18.00	12.50
1937	7.60	21.00	14.30
1938	8.00	23.00	15.50
1939	8.80	26.00	17.40
1940	9.20	28.00	18.60

Tabela nr. 1

<sup>46</sup> Ahmet Hadžirović, *Donošenje „Uredbe o utvrdivanju minimalnih nadnica, zaključivanju kolektivnih ugovora, pomirenju arbitraži” 13. februara 1937. godine*, Prilozi br. 1, 1965, Sarajevë, 108.

<sup>47</sup> Tabelat dhe grafikonet janë bërë në bazë të burimeve të Entit Qendror për Sigurimin e Punëtorëve, të Entit Krahinor, të burimeve të inspeksioneve të punës, të shoqatave profesionale të punëtorëve, të burimeve arkivale, të literaturës, të shtypit dhe shënimeve të mbledhura në terren. Me këtë rast i shpreh falënderim Ramadan Limanit, student i Fakultetit të Shkencave Natyrore, Dega e Matematikës viti i III që më ndihmoi në përpilimin e tabelave dhe të grafikoneve.

Po të krahasojmë pagat maksimale dhe minimale të punëtorëve zejtarë, do të vërejmë se diferenca e tyre është mjaft e madhe. Kjo diferencë vërehet qartë në grafikon, sepse sa më larg gjendet diagrami që paraqet pagat maksimale prej diagramit të pagave minimale, aq më e madhe bëhet diferenca ndërmjet tyre.



grafikoni nr. 1

legjenda:

- diagrami i mëditjeve minimale
- diagrami i mëditjeve mesatare
- · - · - diagrami i mëditjeve maksimale

Në sajë të diagramave në grafikon shohim se pagat maksimale të zejtarëve deri në vitin 1936 pësojnë rënie të vazhdueshme, ndërkaq pagat minimale e arrijnë minimumin në vitin 1935, kur ishin vetëm 6,2 din. Prej vitit 1936 këto paga shënojnë ngritje, e cila vazhdon deri në vitet 1939—1940. Në vitin 1940 pagat minimale ishin 9,20 dinarë, pagat maksimale 28 dinarë dhe ato mesatare 18,60 dinarë.

## b. Pagat e punëtorëve të sharrave dhe të pyjeve

Nga shënimet e tabelës nr. 2 është nxjerrë grafikoni nr. 2, ku janë paraqitur pagat e punëtorëve të sharrave në periudhën 1930—1939. Nga ky grafikoni shihet qartë se pagat e këtyre punëtorëve gjatë kësaj periudhe pësojnë rënie të vazhdueshme. Ato minimumin e tyre e arrijnë në vitin 1935. Mesatarja në këtë vit ishte 13,50 dinarë, minimalja 8 dinarë dhe ajo maksimale 19 dinarë.

Viti	Mëditja minimale	Mëditja maksimale	Mëditja mesatare
1930	12.40	29.00	20.70
1931	11.10	27.00	19.05
1932	10.50	23.00	16.75
1933	9.80	21.00	15.40
1934	8.60	20.00	14.30
1935	8.00	19.00	13.50
1936	9.20	20.00	14.60
1937	9,70	22.00	15.85
1938	10.00	25.00	17.50
1939	10.80	28.00	19.40

Tabela nr. 2

Duke filluar nga viti 1936 diagramet e pagave të këtyre punëtorëve shënojnë ngritje, për ta arritur lartësinë e tyre maksimale në vitin 1939. Në këtë vit pagat minimale ishin 10,8 dinarë, pagat mesatare 19,4 dinarë, ndërkaq pagat maksimale 28 dinarë.


Vlen të theksohet se diferenca ndërmjet pagave maksimale dhe atyre minimale ishte e madhe gjatë gjithë kësaj periudhe.

## c. Pagat e punëtorëve të centraleve elektrike

Nga të dhënat e tabelës nr. 3 është bërë grafikoni nr. 3 i vlerave të pagave minimale, maksimale dhe pastaj është nxjerrë mesatarja e tyre. Pagat minimale të punëtorëve të centraleve elektrike, siç shihet nga vetë grafikoni, kanë qenë mjaft të ulëta. Gjatë viteve 1933—1938 këto paga kanë shkuar duke u rritur me një tempo mjaft të ngadalësuar. Kështu, derisa në vitin 1933 ato ishin 11,5 dinarë, në vitin 1938 arrijnë vetëm në 12,9 dinarë. Në anën tjetër, pagat maksimale prej 30 dinarësh, sa ishin në vitin 1933, arrijnë në 38 dinarë në vitin 1936. Pastaj ato pësojnë rënie të ngadalshme gjatë viteve 1937 dhe 1938, duke zbritur për 3 din. Mesatarja, si varshmëri e pagës maksimale dhe minimale nuk pëson ndonjë ndryshim të madh, por ajo sillet prej 20,75 din. në vitin 1933 në 23,95 din., në vitin 1938.

Viti	Mëditja minimale	Mëditja maksimale	Mëditja mesatare
1933	11,5	30	20,75
1934	8,9	35	21,95
1935	10	37	23,5
1936	9	38	23,5
1937	12,5	35	23,65
1938	12,9	35	23,95

Tabela nr. 3




grafikoni nr. 2

legjenda:

- diagrami i mëditjeve minimale
- diagrami i mëditjeve mesatare
- · - · - · diagrami i mëditjeve maksimale

### ç. Pagat e punëtorëve të xehetarisë

Pagat e punëtorëve të xehetarisë gjatë periudhës së vështruar në Kosovë, marrë në tërësi ishin në nivel më të lartë se pagat e punëtorëve të profesioneve të tjera të kësaj treve. Mirëpo, pagat e punëtorëve xehetarë ndryshonin nga një ndërmarrje në ndër-



grafikoni nr. 3

marrjen tjetër. Gjithsesi në pozitë më të mirë ishin punëtorët e Trepçës dhe ata të Novo Bërdos. Në tabelën nr. 4 janë paraqitur pagat e punëtorëve të Trepçës në sipërfaqe dhe në galeri, gjatë viteve 1931—1936, ku shihen ndryshimet e pagave të punëtorëve të profesioneve të ndryshme të kësaj ndërmarrjeje të madhe xeherore të Kosovës.

Në bazë të tabelës nr. 4 është nxjerrë grafikoni nr. 4, i cili shënon lëvizjet e pagave mesatare të punëtorëve të Trepçës, që punonin në galeri gjatë viteve 1931—1936. Nga ky grafikon shihet se paga më të larta kishin kryepunëtorët, që në njëfarë mënyre luainin rolin e të ashtuquajturës aristokraci punëtore. Këto paga minimumin e tyre e shënuan në vitin 1935 kur ishin 15,7 dinarë, ndërkaq lartësinë më të madhe e arritën në vitet 1931 dhe 1933 (75 din.).

Pagat e zejtarëve në galeri pothuajse pësojnë rënie të vazhdueshme gjatë gjithë kësaj periudhe. Po që se bëjmë një krahasim ndërmjet pagave të zejtarëve dhe të kryepunëtorëve, shohim se ato vetëm në vitin 1931 ishin të barabarta. Me kalimin e kohës ato diferencohen, në mënyrë që në vitin 1931 pagat e zejtarëve të arrinin në 75 din. Ndërkaq, në vitin 1936 ranë në 55 din. Minimumi i tyre është në vitin 1935, kur ato bien në 52,5 din.

Pagat e mihësve dhe të latuesve nuk tregojnë thyerje të theksuar, d.m.th. nuk pësojnë ndryshime të shumta, siç pësojnë ato të punëtorëve të profesioneve të tjera në galeri. Pagat maksimale të këtyre punëtorëve arrihen në vitin 1931 dhe 1934, kur ato janë 65 din., ndërsa minimumin e arrijnë në vitin 1936 me 52,5 din.

Pagat më stabile të punëtorëve në galeri ishin ato të ndihmëslatuesve dhe të vozitësve, të cilat gjatë gjithë kësaj periudhe pë-


MÉDITJET E PUNËTOREVE TE TREPÇES GJATE VITEVE 1931—1936 Tabela nr. 4

Vitet	1931			1932			1933			1934			1935			1936			
	Maks.	Min.	Mes.	Maks.	Min.	Mes.	Maks.	Min.	Mes.	Maks.	Min.	Mes.	Maks.	Min.	Mes.	Maks.	Min.	Mes.	
Profesionet	Kryepunëtorët	90	60	75,00	75	60	67,5	90	60	75,00	70	60	65,00	70	45	37,5	75	55	65,0
	Mihësit dhe latuesit	80	50	65,0	80	45	62,5	80	45	62,5	80	50	65,0	70	40	55,0	65	40	52,5
	Ndihmës-latuesit	45	38	41,5	50	35	42,5	45	35	40,0	40	30	35,0	45	30	37,5	45	35	40,0
	Vozitësit	40	25	32,5	38	25	31,5	38	25	31,5	37	25	31,0	30	25	27,5	43	25	34,0
	Zejtaret	85	65	75,0	75	50	62,5	75	50	62,5	65	45	55,0	65	40	52,5	65	45	55,0
	Ndihmëzejtaret	40	40	40,0	50	35	42,5	45	30	37,5	40	30	35,0	40	25	32,5	50	35	42,5
	Punëtorët e tjerë në galeri	35	30	32,5	30	25	27,5	70	25	47,5	38	25	31,5	38	25	31,5	45	25	35,0
	Kryepunëtorët	85	80	82,5	100	80	80,0	117	80	98,5	95	60	77,5	95	40	67,5	80	50	65,0
	Zejtaret	80	60	70,0	100	56	78,0	100	56	78,0	80	50	65,0	80	40	60,0	80	45	62,5
	Ndihmësit e zejtareve	50	35	42,5	64	28	46,0	56	30	43,0	50	32	41,0	40	25	32,5	50	30	40,0
Nrënësit	25	25	25,0	22	20	21,0	20	20	20,0	20	10	15,0	20	10	15,0	20	10	15,0	
Meditësit e mosh. 18 vjeç.	40	25	32,5	40	24	32,0	64	18	41,0	60	20	40,0	35	20	27,5	45	20	32,5	
Meditësit e mosh. 16-18 vjeç.	25	25	25,0	22	20	21,0	28	16	22,0	18	18	18,0	25	20	22,5	35	25	30,0	
Meditësit e mosh. 14-16 vjeç.	20	15	17,5	22	20	21,0	16	16	16,0	30	17	23,5	30	20	25,0	30	20	25,0	
Meditësit	30	30	30,0	22	22	22,0	20	15	17,5	17	17	17,0	20	20	20,0	20	20	20,0	

NË GALERI

NË SIPËRQAF

sojnë shumë pak ndryshime. Paga më e lartë e ndihmëslatuesve ka qenë në vitet 1932 dhe 1936, (kur arrijnë në 42,5 din.), ndërkaq më e ulët ka qenë në vitin 1934 (35 din.), gjë që bie në sy se diferenca ndërmjet tyre nuk ishte aq e madhe. Po në këtë mënyrë shprehen pagat e vozitësve, të cilat në vitin 1935 shënojnë minimumin (27,5 din.). Ndërkaq, në vitin 1936 ato arrijnë maksimumin (35 din.).




grafikoni nr. 4

Karakteristikë e pagave të të ashtuquajturve punëtorë të tjerë në galeri, përkatësisht të ndihmësejtareve janë ndryshimet e theksuara. Derisa maksimumi i pagave të tyre arrihet në vitin 1933 (47,5 din.), minimumi shprehet në vitin 1935 (27,5 din.), që do të thotë se diferenca e pagave të këtyre punëtorëve ndërmjet këtyre viteve (1933—1935) ishte 20 din.

Në grafikonin nr. 5 janë paraqitur pagat e punëtorëve të Trepçës që punonin në sipërfaqe, shënime këto që janë nxjerrë gjithashtu nag tabela nr. 4. Karakteristikë e të dy grafikoneve, që bie

në sy në shikim të parë, është se, derisa në grafikonin numër 4 paraqiten prerje të shumta të pagave, që do të thotë se pagat e punëtorëve në galeri ndryshonin nga një profesion në tjetrin, në diagramet e grafikonit nr. 5 nuk kemi prerje të këtilla. Në fakt, pagat e punëtorëve të kësaj kategorie kanë pësuar ngritje dhe rënie, por në njëfarë dore kanë pasur përafërsisht kahje të njëjtë, gjë që edhe diagramet e shprehin një gjendje të këtyllë. Mirëpo, po të studiohet në mënyrë detaje ky grafikon, vërehet se edhe



grafikoni nr. 5

ndërmjet profesioneve të kësaj kategorie kishte dallime. Kështu, p.sh., përderisa pagat e kryepunëtorëve dhe të zejtarëve të kësaj kategorie në vitin 1931—1932 ngriten, pagat e ndihmësmihësve dhe të nxënësve pësojnë rënie të vogël.

Është karakteristike për t'u theksuar se paga e kryepunëtorëve në sipërfaqe është më e lartë se e kryepunëtorëve në galeri. Mirëpo, kjo gjendje ka të bëjë edhe me të gjitha vitet e shënuara në grafikon. Pagat maksimale dhe ato minimale të punëtorëve në sipërfaqe nuk kanë ndryshuar ashtu siç pësojnë ndryshim pagat e po të njëjtit profesion në galeri, p.sh. paga më e lartë e krye-

punëtorëve në sipërfaqe është në vitin 1933 (98,5 din.), ndërkaq paga më e ulët është në vitin 1936 (65 din.). Zejtarët maksimumin e pagave e arrijnë në vitin 1932—1933 (78 din.), ndërsa pagën më të ulët në vitin 1935 (60 din.).

Lëvizje të theksuar bën diagrami i pagave të ndihmëszejtarëve, i cili në vitet 1933—1934 gati u afrohet pagave të zejtarëve. Paga më e lartë e këtyre punëtorëve është në vitin 1932 (46 din.), ndërkaq ajo më e ulëta në vitin 1935 (32,5 din.).

Janë karakteristike pagat e mëditësve të moshës mbi 18 vjeç, të cilat shprehin tendencë të vazhdueshme të rënies. Kështu prej 25 din., sa ishin në vitin 1931, ranë në 15 dinarë në vitin 1934, për të qëndruar në këtë nivel edhe gjatë viteve 1935 dhe 1936.


Pagat e nxënësve në vitin 1931 ishin 32,5 din. Maksimumin e arrijnë në vitin 1933 (41 din.), ndërsa minimumin në vitin 1935 (27,5 din.), ndërkaq më 1936 ato nivelizohen me pagat e vitit 1931 (32,5).

Siç u tha më lart, pagat e punëtorëve të Trepçës, në krahasim me pagat e punëtorëve të xeheroreve të tjera të Kosovës, ishin shumë më të larta. Gjatë vitit 1931, p.sh., ato dukeshin kështu: në Trepçë 45,95, në Novo Bërdë 42, në Janjevë 43,22, ndryshime këto më pak të theksuara. Ndërkaq, pagat e punëtorëve të xeherores „Kosova” prej 16,19 din. të Devës 7,6 din. dhe të Drenicës 12,5 ishin shumë më të ulëta se ato të Trepçës dhe të Novo Bërdës e Janjevës. Këto ndryshime u ruajtën deri në vitin 1940, përpos pagave të punëtorëve të Novo Bërdës dhe Janjevës, të cilat u barazuan me ato të Trepçës, meqë në këtë vit këto dy xeherore hyjnë në kuadrin e Trepçës.

Për të ilustruar gjendjen e pagave të punëtorëve të xeheroreve të Kosovës gjatë periudhës në fjalë kemi përgatitur grafikonin nr. 6., i cili ka dalë nga tabela nr. 5.

VITI	1931	1932	1933	1934	1935	1936	1937	1938	1939	1940
TREPÇA	45,95	42,49	44,12	41,27	42,62	43,12	48,2	48,2	48,2	48,2
NOVO BËRDA	42	23,76	29,33	38,83	40,08	41,96	47,79	48,2	48,2	48,2
JANJEVA	43,22	23,76	32,79	38,83	40,83	44,45	42,79	48,2	48,2	48,2
KOSOVA	16,19	16,19	32,5	32,5	32,5	32,5	32,5	32,5	32,5	32,5
SHALI-DARI, JEZERINA, OSTROVICA	8,2	8,2	8,35	8,35	8,35	9,83	9,83	9,83	9,83	9,31
DEVA	7,6	7,6	7,6	7,6	7,6	7,6	7,6	7,6	7,6	7,6
DRENICA	12,5	12,5	12,5	12,5	12,5	12,5	12,5	12,5	12,5	12,5

Tabela nr. 5



grafikoni nr.6

legjenda:

- Mëditja mesatare e xehëtarëve të Trepçës
- ..... Mëditja mesatare e xehëtarëve të Novo Bërdës
- Mëditja mesatare e xehëtarëve të Janjevës
- Mëditja mesatare e xehëtarëve të Kosovës
- · - · - Mëditja mesatare e xehëtarëve të Shalldarit, Jezerinës dhe Ostrovicës

#### d. Raporti ndërmjet pagave mesatare të Jugosllavisë dhe të Kosovës


Në tabelën nr. 6<sup>48</sup> janë paraqitur pagat mesatare të punëtorëve në Kosovë (gjatë viteve 1933—1940), mesatarja e pagave në nivel jugosllav (1933—1939) dhe dallimi në përqindje (%) ndërmjet tyre. Në bazë të kësaj table është nxjerrë grafikoni nr. 7, në të cilin shihen qartë dallimet ndërmjet pagave mesatare të punëtorëve të Kosovës dhe pagave mesatare të punëtorëve në nivel të

<sup>48</sup> Mesatarja e pagave në Jugosllavi është nxjerrë nga AJ—244/A dhe Metodija Sokolovski, Najamnina... , 49, 50.

Pagat mesatare të punëtorëve

Viti	në Kosovë	në Jugosllavi	Dallimi në %
1933	20.03	23.22	13.73
1934	18.25	22.24	18.03
1935	17.12	21.65	20.55
1936	21.03	21.68	3.00
1937	17.85	22.71	21.40
1938	19.14	23.64	19.03
1939	20.60	24.15	14.69
1940	21.98		

Tabela nr. 6.



grafikoni nr. 7

Legjenda:

- Pagat mesatare në Jugosllavi
- - - - - Pagat mesatare në Kosovë

Jugosllavisë. Që në fillim shohim se pagat mesatare të punëtorëve të Kosovës gjatë periudhës së lartpërmendur janë vazhdimisht më të ulëta nga mesatarja e pagave të punëtorëve në Jugosllavi, duke mos u bazuar në burime që flasin për dallime shumë më të mëdha.<sup>49</sup>

Nga grafikoni shihet se diferenca ndërmjet pagave mesatare të punëtorëve të Kosovës dhe pagave mesatare të punëtorëve të Jugosllavisë është më e vogël në vitin 1936 (3%), ndërsaq diferenca më e madhe është në vitin 1935 (20,55%) dhe 1937 (21,4%).

Duhet shtuar se pagat mesatare të punëtorëve të Kosovës i kanë ngritur disa kategori punëtorësh të Trepçës, të cilët kishin paga shumë më të larta se xehetarët e tjerë dhe në përgjithësi shumica e punëtorëve të tjerë të Kosovës.

#### dh. Raporti ndërmjet pagave dhe shpenzimeve të jetës së punëtorëve

Për të konstatuar gjendjen ekonomike të punëtorëve të Kosovës gjatë periudhës së vështruar, duhet të shihen pagat reale të punëtorëve, përkatësisht sasia e mallrave që ata mund të blenin me pagën nominale, ose me sasinë e të hollave që merrnin nga punëdhënësi për fuqinë e tyre punëtorë të shitur.

Gjatë gjithë periudhës së vështruar, pagat nominale të punëtorëve të Kosovës qëndronin në shpërpjesëtim të theksuar me pagat e tyre reale. Ky shpërpjesëtim në radhë të parë ishte si rrjedhim i raporteve ekonomike shoqërore që mbretëruan në këtë trevë. Këto raporte ndikuan mjaft në gjendjen ekonomike të punëtorëve, sepse, siç u pa më lartë, ngritja e çmimeve të artikujve të konsumit të gjerë ishte dukuri e përhershme gjatë gjithë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, ndërsaq pagat reale të punëtorëve tregonin rënie të vazhdueshme. Pjesa dërmuese e punëtorëve të Kosovës punonte vetëm sa për të siguruar kafshatën e gojës.

Në bazë të kriteve të atëhershme jugosllave, kemi përgatitur tabelën nr. 7 të shpenzimeve mujore të një familjeje 4-anëtarëshe, duke u mbështetur në çmimet e artikujve të konsumit të gjerë në Kosovë gjatë viteve 1933—1940.<sup>50</sup>

Në bazë të Tabelës nr. 7 kemi paraqitur në mënyrë grafike lëvizjet e shpenzimeve të artikujve të konsumit të gjerë për periudhën 1933—1940 në grafikun nr. 8.


<sup>49</sup> Shih *Neslužbeni deo Socijalnog Arhiva*, 1—2, Beograd, 1983, sipas saj pagat mesatare në Jugosllavi ishin: 1933—87, 4, 1934—83, 9, 1935—81, 5, 1936—81, 6.

<sup>50</sup> Tabela është përgatitur në bazë të shënimeve të shtypit të Kosovës („Glas sa Zvečane”, „Kosovske Novine”, „Osvit”, „Službeni List Vardarske Banovine”), Këto shënime janë plotësuar edhe nga shtypi i vendit („Radničke Novine”, „Ujedinjeni Sindikati”, „Radnička Zaštita” dhe „Socijalni Arhiv”).

Shpenzimet mujore për një familje katërrantëshe

Tabela nr. 7

	VITET							
	1933	1934	1935	1936	1937	1938	1939	1940
Saia e artikuj- ve ushqimorë për një muaj për familjen katërrantëshe	14,4 din.	15,2 din	15,6 din.	15,6 din.	15,9 din.	10,4 din.	16,8 din.	16,8 din.
Miell gruri 12 kg	12 din.	12 din.	14 din.	15,2 din.	15,7 din.	15,9 din.	16 din.	16 din.
Miell misri 12 kg	90 din.	90 din.	90 din.	90 din.	97 din.	102 din.	108 din.	103 din.
Bukë 36 kg	4,8 din.	5,2 din.	6,4 din.	8 din.	8,6 din.	9,4 din.	10,4 din.	10,4 din.
Veasë 8 copë	9,6 din.	9,6 din.	16 din.	16 din.	20 din.	35 din.	48 din.	38 din.
Patate 16 kg	32 din.	32 din.	100 din.	100 din.	112 din.	116 din.	120 din.	120 din.
Qumësht 40 lit.	24 din.	26 din.	28 din.	32 din.	37 din.	39 din.	40 din.	40 din.
Mësh 4 kg	32 din.	34 din.	34 din.	40 din.	51 din.	65 din.	72 din.	72 din.
Vaj 4 lit.	16 din.	24 din.	32 din.	32 din.	36 din.	39 din.	40 din.	48 din.
Pula 4 copë	16 din.	20 din.	24 din.	40 din.	62 din.	83 din.	98 din.	96 din.
Groshtë 6 kg	250,8 din.	268 din.	360 din.	363,8 din.	455,2 din.	520 din.	553,2 din.	563,2 din.
Shuma								




grafikoni nr.8

*Lëvizjet e shpenzimeve mujore për një familje katëranëtarëshe 1933-1940*

Në grafikoni nr. 7 janë llogaritur çmimet për sasinë e produkteve më të domosdoshme për jetë, që i konsumonte një familje punëtore 4-anëtarësh. Ngritja e çmimeve të artikujve të lartshënuar shkaktonte shtrenjtimin e kostos së jetesës. Në rastin tonë sasia fizike dhe gama e artikujve ushqimor është marrë e pandryshuar gjatë gjithë viteve të paraqitur në tabelë (1933—1940), kurse çmimet janë dhënë të ndryshuara, ashtu siç janë ngritur në atë kohë. Është e qartë se këtu është abstrakuar rritja e kërkesave primare dhe atyre të dorës së dytë. Megjithatë, kur merren parasysh edhe të marrat (pagat) e punëtorit në raport me këtë lëvizje çmimesh, është e qartë se pagat as për së afërmi nuk e përcillnin ngritjen e tyre., gjë që bën të konkludojmë se familja e rastit tonë me kohë ka bërë një abstenim të dhunshëm edhe nga konsumimi i këtyre artikujve më të domosdoshëm për jetë. Pos kësaj, po qe se shtojmë se familja kosovare në këtë kohë kishte

mesatarisht 7 anëtarë,<sup>51</sup> atëherë del se shpenzimet mujore të kësaj familjeje për artikujt më të domosdoshëm për jetesë janë shumë më të mëdha, gjë që del vetëvetiu se kostoja e jetesës e familjes së punëtorit në Kosovë ishte edhe më e lartë se në shekullin tonë.



grafikoni nr.9

legjenda:

- pagat mesatare mujore  
 - - - - - shpenzimet mujore për një familje katër anëtarëshe

Për të parë gjendjen ekonomike të punëtorëve të kësaj treve kemi dhënë grafikonin nr. 9, në të cilin shihet përpjesëtimi ndërmjet shpenzimeve mujore të artikujve të domosdoshëm për një familje katëranëtarëshe me pagë mesatare mujore të punëtorëve të kësaj treve dhe diferencën ndërmjet pagës mesatare e shpenzimeve mujore.

<sup>51</sup> Shih *Kuće i domačinstva u Jugoslaviji*, „Socijalni Arhiv”, nr. 4, 1983, 33–37, Sipas së cilës del se mesatarja e familjes së Kosovës gjatë kësaj periudhe ishte mbi 7 anëtarë.

Në grafikon (nr. 8) është paraqitur raporti i të ardhurave mujore dhe shpenzimeve mujore për një familje 4-anëtarëshe për periudhën 1933—1940. Në bazë të të dhënave që kemi disponuar del se të ardhurat mesatare mujore për një punëtorë kanë qenë:

në vitin	1933	500 din.
	1934	456 din.
	1935	428 din.
	1936	526 din.
	1937	446 din.
	1938	478 din.
	1939	515 din.
	1940	550 din.

Teksojmë se këtu nuk janë përfshirë të gjitha profesionet dhe kategoritë e punëtorëve, por megjithatë kjo është pasqyrë e të ardhurave të klasës punëtore në Kosovë gjatë periudhës në fjalë.

Nga grafikoni (nr. 8) shihet se gjendja ekonomike e klasës punëtore në Kosovë prej vitit 1933 deri në vitin 1935 shkon duke u keqësuar për shkak të ngritjes së shfrenuar të çmimeve të artikujve të konsumit të gjerë. Ndërkaq, pagat nominale tregojnë kahje të kundërt, gjë që reflektohet në rënien e theksuar të aftësisë blerëse të punëtorëve. Kjo gjendje, sikur është zbutur nominalisht gjatë viteve 1936—1937. Këtë e themi për shkak se pagat nominale u ngritën në njëfarë dore, por ato edhe mëtej ishin në shpërpjesëtim me ngritjen e çmimeve të artikujve të konsumit të gjerë. Këtë e ilustron edhe diagrami i shpenzimeve mujore, i cili në vitin 1937 kalon mbi diagramin e të ardhurave mujore, gjendje kjo që vazhdon të keqësohet pandërprerë deri në vitin 1940.

Gjendjes së paraqitur në këtë grafikon duhet t'i shtohen edhe kërkesat e tjera që punëtori ishte i detyruar ti hiqte. Në këtë plan bënin pjesë tagrat e ndryshme, siç ishin: tagrat shtetërore, tagrat e banovinës dhe tagrat e komunës.<sup>52</sup> Që nga janari i vitit 1925. Qeveria miratoi Ligjin mbi tatimet e shumta të punëtorëve, siç ishin dogana për veshmbathje, tatimi në qarkullimin e punës, tagra e monopolit, dogana për shpenzimet e artikujve të përdorimit të gjerë, tatimi për shtëpi etj., që gjithsej bënin 3,5% të pagës mujore të punëtorit.<sup>53</sup>

Krahas kësaj, duhet shtuar se një pjesë e punëtorëve të kësaj treve i ekspozojë shpenzimeve mujore për banesë, përkatësisht për qiranë e banimit. Raste të këtilla kemi me punëtorët që nuk kishin shtëpitë e tyre dhe banonin nëpër qytete, si dhe me punëtorët e të të ashtuquajturave koloni punëtorësh. Në të dy rastet, qiraja mujore e punëtorëve ishte mjaft e lartë, që gjithashtu e bënte edhe më të vështirë gjendjen ekonomike të punëtorëve të kësaj kategorie.

<sup>52</sup> „Kosovske Novine”, 13. 6. 1936, Trošarina ili prirez.

<sup>53</sup> „Organizovani radnik”, nr. 38, 25. 5. 1925, *Položaj radničke klase u Srbiji 1926—1931*.

Në fund, po shtojmë edhe kërkesat e domosdoshme të punëtorëve të Kosovës dhe familjeve të tyre për veshmbathje dhe gjëra të tjera. Është vështirë të merret me mend se në ç'masë ai ishte në gjendje që me pagën e tij të vogël të dilte në fund të muajit. Punëtori i Kosovës gjatë kësaj periudhe preokupim kryesor të jetës së tij e kishte sigurimin e ushqimit të domosdoshëm për ekzistencë, ndërkaq nga kërkesat e tjera shpirtërore (argëtimi dhe jeta kulturore) ai ishte i privuar. Vetëm po të kihen parasysh të gjitha këto elemente del e qartë gjendja ekonomike e punëtorëve të Kosovës, që ishte më e rëndë se e shumicës së punëtorëve të viseve të Jugosllavisë.

*Dr. Ramiz Abdyl*

#### LES SALAIRES DES OUVRIERS EN KOSOVÉ RELATIFS AU NIVEAU DE LA VIE PENDANT LES DEUX GUERRES MONDIALES (1918—1941)

##### Résumé

La situation fut conditionnée plutôt par des facteurs objectifs et se présente bien par leurs salaires, l'un des éléments principaux de leur existence économique. Le salaire moyen en Kosové dans la période des deux guerres mondiales était inférieur à la moyenne par rapport à la majorité d'ouvriers d'autres régions de Yougoslavie.

La situation fut conditionnée plutôt par des facteurs objectifs et subjectifs. Nominalement les salaires des ouvriers de cette région pendant ce temps-là se différençaient d'une ville à l'autre, entre diverses professions d'ouvriers, même à l'intérieur d'une profession dans un établissement. A la différenciation d'autres ouvriers des bons salaires touchaient les ouvriers de certaines catégories de Trepça, tandis qu'un salaire minimum touchaient les manoeuvres auxquels appartenaient le plus grand nombre des ouvriers de la Kosové. Une telle situation décèle que l'ouvrier ait comme préoccupation la procurence des conditions élémentaires de la vie.